



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRISTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/32/24

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga av. G.Z ndaj gjyqtarit J.M, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë: 03.01.2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e ushtruar nga av. G.Z të paraqitur ndaj gjyqtarit J.M, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

Me datë 12.12.2024, av. G.Z ka parashtruar ankesë disiplinore ndaj gjyqtarit J.M, me pretendimet se në fillim të procedurës gjyqësore në cilësinë e të autorizuarës së palës paditëse në lëndën C.nr.152/23 ka qenë av. M.Z.S, mirëpo meqenëse e njëjta nga ana e Ministrisë së Drejtësisë është emëruar noterë, lëndët të cilat ishte e angazhuar i kanë kaluar në përfaqësim avokatëve të tjerë. Për këtë arsye, sipas tij lënda në fjalë me datë 05.09.2024 me autorizim bartës është bartur nga avokatja e mëparshme te av. G.Z, ku edhe janë njoftuar se seanca e radhës në këtë çështje është e përcaktuar të mbahet me datë 13.09.2024. Sipas tij, gjyqtari J.M nuk ka marrë parasysh fare njoftimin e dërguar në lidhje me pa mundësinë për pjesëmarrje në seancën e caktuar me datë 13.09.2024, për shkak se po në këtë ditë dhe orë ka qenë e caktuar një seancë tjetër në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë, për lëndën PKR.nr.93/14. Parashtruesi i ankesës ka deklaruar se njoftimi ju është dërguar gjyqtarit edhe përmes email adresës zyrtare si dhe përmes postës rekomande, me kërkesë për shtyrje të seancës së përcaktuar për një datë tjetër, duke i bashkangjitur autorizimin bartës, procesverbalin e seancës së datës 01.06.2024 me anë të së cilës dëshmohet se në cilësinë e avokatit ka seancë të caktuar me datë 13.09.2024 në ora 09:00 në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë. Sipas tij, përkundër që kërkesa për shtyrje të seancës ishte e mbështetur në prova materiale, gjyqtari i çështjes me datë 13.09.2024 kishte zhvilluar seancën gjyqësore me ç rast kishte nxjerrë Aktvendimin me të cilin është konsideruar e tërhequr padia e paditësit Mehdi Gerxhaliu, me arsyetimin se av. M.Z.S ishte njoftuar gojarisht në seancën paraprake dhe se ajo nuk do të pranoj ndonjë ftesë të veçantë, dhe meqenëse nuk është paraqitur në seancë dhe nuk e ka arsyetuar mungesën e saj, gjykata ka vendosur në bazë të nenit 423.3 të LPK-së. Sipas këtij vendimi, parashtruesi i ankesës pretendon se gjyqtari siç duket nuk ka

arritur para seancës të pranoj parashtrësën-kërkesën për shtyrje të seancës të dërguar përmes postës zyrtare dhe e-mail adresës, andaj me datë 02.10.2024 i jemi drejtuar gjyqtarit me propozim për kthim në gjendjen e mëparshme, me shpresë se i njëjti do ta vlerësoj drejtë këtë propozim. Tutje ka deklaruar se nga i njëjti nuk është pranuar asnjë përgjigje, andaj sipas tij është detyruar përmes ankesës kundër Aktvendimit përkatës, ti drejtohet Gjykatës së Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, por edhe duke ju drejtuar Kryetares së Gjykatës me qëllim të njoftimit në lidhje me veprimet a po mosveprimet e gjyqtarit përkatës. Tutje ka deklaruar se në këto rrethana, me qëllim të sqarimit ka kërkuar takim me gjyqtarin e rastit, por i njëjti nuk e ka pranuar.

Sipas parashtruesit të ankesës, Aktvendimi i kontestuar është marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, ku veprimet a po mosveprimet e gjyqtarit përkatës dëmtojnë besueshmërinë e qytetarëve në sistemin e drejtësisë në përgjithësi, e në gjykatën përkatëse në veçanti, andaj ka kërkuar të vlerësohen shqetësimet e ngritura pasi që me këto veprime është dëmtuar në mënyrë direkte e drejta e palës në procedurë, me pasojë humbjen e të drejtës në kompensim të dëmit material dhe jo material nga e paditura.

Me datë 11.12.2024, Kryetarja e Gjykatës duke vepruar në kuptim të nenit 9 paragrafi 5 i Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës për pranimin e ankesës disiplinore të parashtruar nga av. G.Z ndaj gjyqtarit J.M.

Gjyqtari J.M tutje ka deklaruar se me datë 11.12.2024 ka vendosur në lidhje me kërkesën e përfaqësuesit të autorizuar për kthim në gjendje të mëparshme, të cilin vendim e ka dërguar për përkthim pranë përkthyesit të Gjykatës me datë 12.12.2024. Sipas gjyqtarit, menjëherë pas pranimit të vendimit të përkthyer, të njëjtin e ka eksepduar tek palët.

Në referim të pretendimeve të parashtruesit të ankesës si dhe bazuar në Ligjin për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, Autoritetin Kompetent gjeti se:

- ankesa disiplinore është e pabazuar.

Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë vlerëson se në rastin konkret pas shqyrtimit të ankesës, ka ardhur në përfundim se pretendimet e parashtruara nuk mund të jenë subjekt i vlerësimit në procedurën disiplinore pasi që nuk është kompetencë e autoritetit kompetentë të vlerësoj nëse gjyqtari i çështjes ka vendosur drejtë a po jo me rastin e hudhjes poshtë të padisë a po vlerësimin e drejtë a po jo të provave të bashkangjitura në kërkesën për shtyrje të seancës gjyqësore, pasi që këto pretendime mund të jenë subjekt i vlerësimit të gjykatave të shkallëve më të larta, e që në rastin konkret të njëjtat janë ngritur duke ankimuar pikërisht këtë vendim në Gjykatën e Apelit.

Kryetarja e Gjykatës nuk ka kompetencë të vlerësoj vendimmarrjen e gjyqtarit a po mënyrën se si gjyqtari trajton lëndën deri në vendimmarrje, pasi që rregullat e trajtimit të një çështje të caktuar në procedurë civile janë të caktuara me ligjin në fuqi, andaj nëse palët pretendojnë se vendimi i gjyqtarit është i përfshirë në shkelje të dispozitave ligjore apo procedurale, legjisllacioni në fuqi ka paraparë mekanizmat ligjor të goditjes së vendimeve me mjete të rregullta a po të jashtëzakonshme në instanca më të larta.

Ndërsa, pretendimi se gjyqtari i çështjes nuk ka vendosur në lidhje me kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme, Autoriteti Kompetent në bazë të të dhënave të siguruara ka konstatuar

se gjyqtari i çështjes me datë 11.12.2024 ka nxjerrë Aktvendimi C.nr.152/23, sipas të cilit ka vendosur në lidhje me kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme të parashtruar nga përfaqësuesi i palës paditëse, ku të njëjtin vendim me datë 12.12.2024 e ka dërguar në Zyrën e Përkthimeve të gjykatës, ku menjëherë pas pranimit të vendimit të përkthyer, i njëjti ju është ekspeduar palëve.

Andaj, fakti se palët janë njoftuar me vonesë me Aktvendimin në fjalë, nuk mund të konsiderohet shkelje disiplinore për gjyqtarin e çështjes, pasi që i njëjti brenda afateve ligjore ka vendosur në lidhje me kërkesën e parashtruar nga palët.

Në këtë drejtim, me nenin 107 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës parashihet: “Gjyqtarët, gëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe për veprimet e tjera të ndërmarra që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësive të tyre si gjyqtarë”, e po ashtu parimi i njëjtë mbrohet edhe nga instrumentet ndërkombëtare ku në Deklaratën Universale mbi Pavarësinë e Gjyqtareve, ku parashihet: "Gjykatësit gjatë ushtrimit të detyrave të tyre duhet të jenë të lirë për të vendosur mbi çështjet në mënyrë të paanshme, në përputhje me vlerësimin e tyre të lirë të fakteve dhe të kuptuarit e tyre të ligjit”.

Nga të lartcekurat, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t’i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/32/24, me datë:03.01.2025

Albina Shabani Rama

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë